

V E N D I M
Nr.359, datë 25.3.1996

**PËR RREGULLIMIN E KOHËS SË PUNËS DHE TË PUSHIMIT TË ROJAVE DHE
PUNONJËSVE TË TJERË, TË CILËT PËRMBUSHIN FUNKSIONE TË NGJASHME ME TA**

Në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Personeli rojë përfshin rojat e natës, portierët dhe punonjës të tjerë që përbushin funksione të ngjashme me ta dhe kur koha e punës së tyre konsiston, në një masë të madhe, në qenien thjesht të pranishëm.

Kohëzgjatja maksimale javore e punës është 60 orë si mesatare në 2 javë. Kjo kohëzgjatje nuk mund t’i kapërcejë 66 orët.

Pushimi ditor duhet të zgjasë të paktën 12 orë si mesatare për 2 javë, por të paktën 9 orë në një interval 24-orësh. Pushimet nuk duhet të ndahen. Pushimi ditor mund të reduktohet, në raste të rralla, me pëlqimin e punëmarrësit:

a) kur shfrytëzimi e kërkon urgjentisht një gjë të tillë;

b) një herë në javë, me qëllim që pushimi javor të bëhet të paktën 36 orë pa ndërprerje.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e orëve shtesë.

Maksimumi i orëve shtesë duhet të jetë 2 orë në ditë dhe 90 orë në vit për çdo punëmarrës.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë, në raste të jashtëzakonshme joperiodike, të punuarit natën. Në këtë rast jepet një shtesë page prej 25 për qind.

Rojat e natës, që punojnë të dielave e për pasojë kapërcejnë kohëzgjatjen maksimale javore të punës, duhet të kenë, në javën paraardhëse apo atë pasardhëse, një pushim kompensues të së njëjtës kohëzgjatje.

Pushimi javor duhet të përfshijë të paktën 20 të diela.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi